



Prishtinë, 10.07.2026  
Kodi i ZRRE-së: V\_3271\_2026

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës me shenjë K.DH.SH.II.nr. 1424/25;
- Vendimin e DMK-së me nr. ZRrE/DMK\_V\_2941\_04\_26, i dt. 02.04.2026.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2026 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e subjektit juridik **T H L.L.C.**, përfaqësuar sipas Autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve Vokshi & Lata, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK\_V\_2941\_04\_26 i datës 02.04.2026.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së.

### A r s y e t i m

Me datë 22.07.2026, subjekti juridik TMD Holding L.L.C., ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve, duke theksuar ndër të tjera se – sipas nenit 37 të Ligjit për Energjinë Elektrike, konsumatorët të cilët duhet të vazhdojnë të furnizohen me tarifa të rregulluara, janë konsumatorët familjar dhe jomfamiljar, që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se 10 mil/EUR ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës. Duke qenë se, ankuesi e tejkalon vetëm njërin kriter, i njëjti vlerëson që duhet vazhduar që të furnizohet me tarifa të rregulluara. Kërkon aprovimin e ankesës si dhe që të obligohet Kompania Kosova për Furnizim me Energji Elektrike – KESCO Sh.A., që subjektin juridik të vazhdoj ta faturtoj në kuadër të obligimit me shërbim universal.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit relevant, DMK ka nxjerrë Vendimin me nr. ZRrE/DMK\_V\_2941\_04\_26, përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit lidhur me kundërshtimin e procesit të liberalizimit të tregut.

Bordi i ZRrE-së për vlerësimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, lidhur me këtë ankesë, i ka shqyrtuar këto prova materiale: Ankesën e subjektit juridik, Vendimin e kontestuar, Njoftimin e KESCO-s, si dhe Listën e subjekteve juridike nga Administrata Tatimore e Kosovës, me qarkullim mbi 10 mil/EUR dhe mbi 50 të punësuar. Pasi që janë vlerësuar të gjitha provat veç e veç dhe ndërlidhur me njëra tjetrën, Bordi ka gjetur se, ankesa e konsumatorit **është e pabazuar** sepse:



Pas analizimit me kujdes të rastit të konsumatorit, dhe duke iu referuar të dhënave zyrtare të Administratës Tatimore të Kosovës, vihet re që, subjekti juridik T H L.L.C., me NUI i ka mbi 50 të punësuar, dhe rrjedhimisht, i plotëson kriteret për të kaluar në tregun e hapur të energjisë elektrike.

Procesi i liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, është një detyrim ligjor, i përcaktuar me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2016. Në këtë kuptim, procesi i derregullimit dhe liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, në ligjet e sektorit të energjisë, derivon nga obligimet kontraktuale që ka Republika e Kosovës, si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

ZRrE rithekson faktin se, procesi i liberalizimit, është i bazuar në dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike nr. 05/L-085 dhe në vendimin përkatës të ZRrE-së, për daljen në tregun e hapur për ndërmarrjet ekonomike, të cilat e tejkalojnë njërin nga kriteret e përcaktuara – më shumë se 50 të punësuar ose qarkullim vjetor mbi 10 milionë EUR.

Po ashtu, edhe përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me shenjen P.A. nr. 18/2025, është vërtetuar se e drejta për furnizim me tarifa të rregulluara, u takon vetëm konsumatorëve të kualifikuar për Shërbim Universal, që është në përputhje të plotë me Vendimin e Bordit të ZRrE-së për tarifat me pakicë për vitin 2025 dhe Direktivën për Energji Elektrike të Bashkimit Evropian 2009/72/EC. ZRrE sipas dispozitave të Ligjit për Energjinë Elektrike, ka për obligim të përcaktojë tarifa të energjisë elektrike me pakicë, vetëm për konsumatorët e energjisë elektrike që e gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe jo për konsumatorët që nuk i plotësojnë kriteret e furnizimit me shërbim universal. Rrjedhimisht, Ligji për Energjinë Elektrike përcakton që, këta konsumatorë duhet të furnizohen në treg të hapur. Furnizimi me energji elektrike në tregun e hapur për këta konsumatorë, është detyrim ligjor dhe në këtë kuptim, i tejkalon kompetencat e ZRrE-së.

Në të njëjtën kohë, referuar edhe Aktvendimit për Papranueshmëri, të Gjykatës Kushtetuese të dt. 23.03.2026, me nr. Ref. RK2990/26, ndër të tjera është konstatuar që – *“Në rrethanat e rastit konkret, në këndvështrimin e Gjykatës, konstatohet se gjykatat e rregullta kanë dhënë arsye të mjaftueshme për refuzimin e kërkesës për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë. Në këtë drejtim, spikasin arsyetimet e tyre, si vijon: (i) mungesa e provave të mjaftueshme – parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm ekonomik, siç kërkohet nga neni 100 paragrafët 1 dhe 2 të LKA-së; (ii) karakteri rekomandues i provave mbështetëse – Opinioni i Avokatit të Popullit kishte karakter vetëm rekomandues dhe nuk krijon efekt detyrues juridik; po ashtu, analiza e Odës Ekonomike dhe udhëzuesi i ZRRE-së nuk përbëjnë bazë të plotë për vendosje; (iii) konteksti ligjor i liberalizimit – procesi i liberalizimit të tregut të energjisë elektrike është i paraparë me nenin 37 (Furnizimi me energji elektrike në kuadër të shërbimit universal) të Ligjit për Energjinë Elektrike, është zhvilluar gradualisht që nga viti 2016 dhe deri më 2025 janë licencuar 22 operatorë, duke dëshmuar natyrën e tij të ligjshme dhe të kontrolluar; (iv) interesi publik – liberalizimi i tregut synon nxitjen e konkurrencës, uljen e çmimeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, prandaj përbën interes publik që nuk mund të cenohet përmes caktimit të një mase të përkohshme; (v) mungesa e provave për dëmin konkret – pretendimet për dëme të rënda dhe të pakthyeshme nuk janë mbështetur me prova konkrete, por vetëm me konstatime të përgjithshme e abstrakte; dëmi duhet të jetë real dhe i provuar, jo hipotetik; (vi) karakteri monetar i dëmit – dëmi i pretenduar lidhet me pagesa monetare për energjinë elektrike të harxhuar, i cili, në rast*



*të konstatimit të paligjshmërisë së aktit, mund të llogaritet dhe kompensohet më vonë, prandaj nuk përbën dëm të pariparueshëm; (vii) lidhja me çështjen kryesore – pretendimet e paraqitura lidhen me themelin e padisë, për të cilën gjykata e rregullt do të vendosë në mënyrë meritore, dhe nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për masë sigurie”.*

Bordi i ZRrE-së duke u bazuar në të dhënat zyrtare të ATK-së, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, si dhe në Ligjin për Energjinë Elektrike, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, Kryesues

---

Lutfije Dervishi, Anëtare

---

Gani Buçaj, Anëtar

---

Arta Isufi, Anëtare

---

Adnan Preniqi, Anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- Arkivit të ZRrE-së.
- Subjektit juridik **T H LLC**